



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Titulli: Kryetari të Komunës
Nr. 725
Data e num. D. 8 6/23
Br. str./No. pg. 165

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna, nenit 74 dhe 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, i datës 29.3.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit me Nr. Prot. 02/99/23, i datës 1.2.2023, për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Projektbuxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2024-2026

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi me Nr. Prot. 02/99/23, i datës 1.2.2023 për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Projektbuxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2024-2026.
2. Pika 1.7. e vendimit bazik ndryshohet dhe plotësohet, si në vijim:

1.7. Fjolla Duraku, caktohet anëtare e komisionit, në vend të Albulena Rexha.
3. Pikët e tjera të vendimit bazik me Nr. Prot. 02/99/23, i datës 1.2.2023, mbesin të pandryshuara.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Me vendim 02/99/23 të datës 1.2.2023, është caktuar Grupi Punues për hartimin e Projektbuxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2024-2026.

Duke marrë parasysh se Albulena Rexha, e cila me vendimin bazik është caktuar anëtare e Grupit Punues, nuk është pjesë e Komunës së Rahovecit, është i domosdoshëm zëvendësimi i saj dhe caktimi i Fjolla Durakut, anëtare e Grupit Punues.

Andaj, nga se u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Fjolla Durakut,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivit.

